

SIMBOLET E KULTIT TE VESHJA E POPULLATËS SHQIPTARE NË RAJONIN E MEDVEGJËS

Qazim NAMANI

Dr. Arkeologji/Trashëgimi Kulturore

Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Kostumet e veshjes së grave të rajonit të Medvegjës pasqyrojnë traditën e lashtë të shprehjes estetike, duke nxjerrë në pah elementet më të lashta dhe domethënëse të artit tradicional që nga parahistoria, Dardanisë antike e deri në ditët e sotme. Motivet e artit popullor të shprehura te kjo veshje janë ngushtë të lidhura me historinë e rajonit dhe me dukuritë tjera kulturore dhe artistike të popullatës autoktone arbërore të kësaj treve. Nga frika e vdekjes, njeriu është mbështetur te mëshira, dhe ndihma e zotit, andaj për të shpëtuar nga fatkeqësitë e ndryshme, në veshje dhe trup, njeriu ka bartur shumë simbole të kultit, që simbolizonin zotin. Një variant i veçantë i stolisjes dhe punimit të veshjes së grave shqiptare, është ajo e trevës së Medvegjës së sotme, andaj në këtë punim do të përqendrohemi për ti analizuar disa simbole të kultit te kjo veshje. Po ti analizojmë me kujdes simbolet e kultit te kjo veshje, do të kuptojmë, hapat e parë të besimit të njeriut, që nga periudha e neolitit e deri në ditët e sotme. Te kjo veshje gjejmë simbolikën e figurave gjeometrike, të spirales lakores, vijave zik-zake, trekëndëshit, rombë, motivet lunare, solare, htonike, florale, zomorfe etj, me të cilat lidhen edhe krijimtaria e motiveve të artit që u krijua nga njeriu në kohët e lashta.

Fjalë kyçe: Dardani, Medvegja, Veshja, Art, Kultit, Gjeometrike, florale, zomorfe.

ABSTRACT

The costumes of the women of the Medvedja region reflect the ancient tradition of aesthetic expression, highlighting the most ancient and significant elements of traditional art from prehistory, ancient Dardania to the present day. The motifs of folk art expressed in this dress are closely related to the history of the region and other cultural and artistic phenomena of the indigenous Arberian population of this region. Out of fear of death, man has relied on mercy, and the help of God, so to escape various misfortunes, in clothing and body, man has carried many symbols of the cult, which symbolized god. A special variant of the decoration and workmanship of Albanian women is that of the region of present-day Medvedja, so in this paper I will focus on analyzing some symbols of the cult of this dress. If we carefully analyze the symbols of the cult in this dress, we will understand, the first steps of human faith, from the Neolithic period to the present day. In this dress we find the symbolism of geometric figures, curved spiral, zigzag lines, triangles, rhombuses, lunar motifs, solar, htonic, floral, zomorphic, etc., which are related to the creation of art motifs created by man in ancient times.

Key words: Dardani, Medvedja, Clothing, Art, Cult, Geometric, floral, zoomorphic.

HYRJE

Tradita e artit në Dardaninë Lindore, e kultivuar, me shekuj në kulturën materiale, është kulturë mijërvjeçare, origjinale, autentike e krijuar nga fiset e lashta me origjinë e me etni iliro-dardane e kësaj treve. Arti dardan u ruajt dhe u zhvillua mjaftë shumë gjatë periudhës romake, dhe asaj mesjetare. Me ardhjen nga lindja të fiseve sllave e avarëve në këto treva, dhe ngulitjes së tyre në trojet tona, shumë nga

tiparet e artit tradicional shqiptar u rrezikuan. Fiset sllave e kanë përvetësuar, dhe më shekuj e kanë vjedhur e falsifikuar këtë kulturë, duke u munduar për ta përvetësuar e quajtur kulturë sllave, trake, avare, apo edhe romake, me të vetmin qëllim mohimin e kulturës së lashtë iliro-dardane të kësaj treve. Veshjet tradicionale etnike e kombëtare, të fiseve ilire e trakase, edhe pse ishin përherë në presion të asimilimit, me vështirësi dhe xhelozitë të madhe, arritën që të ruajnë disa tipare dhe karakteristika specifike etnografike autoktone, të cilat e dëshmojnë lashtësinë e largët të zhvillimit të artit e kulturës, që nga pellazgët, ilirët, arbërorët e deri te shqiptarët e sotëm në Gadishullin Ilirik. Popujt që u dyndën në trojet ilire, nga popullata autoktone morën, elemente të kulturës si: veshjet, vallet, muzikën, këngët, mitet, andaj këto huazime të tyre vërehen qartë në veshje, dhe melosin e tyre popullorë, por përkundër kësaj u ruajtën dallime të dukshme, në melosin dhe traditën e lashtë të arbërve, sepse sllavët kurrë nuk e arritën shkallën e lartë të zhvillimit të artit dhe etnokulturës së dardanëve. Zbulimet arkeologjike dhe elementet e veçanta etnografike të ruajtura vetëm te shqiptarët e sotëm, dëshmojnë përkatësinë e dikurshme të një etnie iliro-dardane, që jetonte në Gadishullin Ilirik, Mesdhe e më gjerë në shtetet evropiane.

SIMBOLET E KULTIT TE VESHJA E POPULLATËS SHQIPTARE NË RAJONIN E MEDVEGJËS

Duke u bazuar nga këto dëshmi, mund të pohojmë se identiteti i vërtet etnik i një etnie, nuk mund të zbulohet apo të vërtetohet vetëm në bazë të shkrimeve, por vëmendje të rëndësishme duhet kushtuar zbulimeve arkeologjike. Motivet etnografike të gdhendura në gurë, si dhe elementet dhe simbolet e lashta etnografike, që u ruajtën me shekuj te veshjet tradicionale popullore, dhe karakteristikat e artit tonë popullorë, të qëndisura në tekstil, në orendi shtëpiake, të punuara në dru, dhe gdhendjeve në gurë në të gjitha epokat historike, dëshmojnë traditën e mjeshtrit popullor shqiptar. Traditën e lashtë të qëndisjes, së artit tradicional popullorë në tekstil, që nga lashtësia, pa dyshim se sot mund ta gjejmë të ruajtur, shumë në traditën e artizanaleve, te gratë shqiptare nga Medvegja. Simbolet që i hasim te xhubleta, si veshja etnografike më e vjetër, e ruajtur deri me sot te shqiptarët, si dhe elementet e artit, me simbole astrale e mitike para historike, por edhe ato historike, që i hasim sot te veshja e grave shqiptare në rajonin e Medvegjës, padyshim se dëshmojnë autoktoninë, dhe traditën e lashtë, të artit autokton burimor, që nga periudha e matriarkatit, e deri te shqiptarëve të sotëm në këto treva.



Fig. - 1 Veshja e grave shqiptare nga rajoni i Medvegjës, Blerta Ajeti, foto e huazuar nga interneti

Veshjet popullore të një treve, janë vlera kombëtare, dhe estetike, të kulturës së një etnie apo komuniteti, andaj përmes kostumeve mësojmë, për gjurmët e qytetërimit të asaj popullate. Zbukurimi i trupit me veshje elegante, dhe të punuar me motive e simbole të besimit, bëheshin për arsye të mbrojtjes së trupit, nga tragjeditë dhe vuajtjet prej lëndimeve nga njerëzit shpirtzi. Nga frika e vdekjes, njeriu është mbështetur te mëshira, dhe ndihma e zotit, andaj për të shpëtuar nga fatkeqësitë e ndryshme, në veshje dhe trup, njeriu ka bartur shumë simbole të kultit, që simbolizonin zotin. Një variant i veçantë i stolisjes

dhe punimit të veshjes së grave shqiptare, padyshim se është ajo e trevës së Medvegjës së sotme, andaj në këtë punim do të përqendrohemi për ti analizuar disa simbole të kultit të kësaj veshje. Po ti analizojmë me kujdes simbolet e kultit të kësaj veshje, do të kuptojmë, hapat e parë të besimit të njeriut, që nga periudha e neolitit e deri në ditët e sotme. Te kjo veshje gjejmë simbolikën e figurave gjeometrike, të spirales lakores, vijave zik-zake, trekëndëshit, rombit, motivet lunare, solare, htonike, florale, zomorfe etj, me të cilat lidhen edhe krijimtaria e motiveve të artit që u krijua nga njeriu në kohët e lashta. Aleksandër Stipçevici, në librin e tij, *Simbolet e Kultit të Ilirët* shkruan: Duke u mbështetur në bibliografinë e pasur që është shkruar deri më tani, mbi simbolikën e motiveve ornamentale parahistorike, mund të pohojmë se ndër motivet e shumta që dëshmojnë nga zbulimet arkeologjike të ilirët, kanë pasur kuptime simbolike.¹

Ndër motivet që kanë pasur domethënie kulturore ose magjike është edhe spiralja, që na paraqitet si gjurmë e qytetërimit dhe kulturës, që nga koha e paleolitit e deri në ditët tona.² Në të shumtën e rasteve spiralja që haset shpesh në objektet mbi varre, simbolizon nëntokën, apo rrugën e ndërlikuar, që shpirti i të vdekurit është i detyruar të kalojë në botën e errët. Në realitet spiralja në një far forme është mënyra e thjeshtuar e paraqitjes së labirintit. Në disa kultura. Spiralja e ka domethënien e simbolit lunar, dhe shpesh paraqitet me motivet e rrethëve koncentrik, që mund të pohojmë se kishte edhe domethënie solare.³ Meandri, po ashtu kishte domethënie të ngjashme me spiralen, sepse meandri është spiralja e paraqitura me vija të thyera në këndin e drejtë.⁴ Vija valore dhe vija zik-zake, po ashtu në artin e hershëm parahistorik, e ka paraqitur gjarprin si simbol htonik.⁵



Fig. – 2 *Spiralja, lakorja, vija zik-zake, ylli gjashtë cepësh, hëna, lakuriqi i natës, të qëndisura te veshja shqiptare e kësaj treve*

Gjarpërim në lashtësi ka qenë simbol i botes së nëndheshme, e rikrijimit, e mbrojtjes dhe e rrezikut, e pushtetit, etj. Vija të drejta, zik-zake, spirale, trekëndësha, rombe dhe motive kozmike, hëna, dielli, yjet dhe motivet tjera e plotësojnë zbukurimin e xhubletës.⁶ Sipas studiueses Fatbardha Demi, zik-zaku nuk është gjë tjetër veçse përsëritja në vijimësi e figurës gjeometrike V, dhe sipas shumë studiuesve është

¹ Aleksandër Stipçeviq, *Simbolet e Kultit të Ilirët*, Prishtinë, 1979, fq. 9

² Po aty, fq.10

³ Po aty, fq. 11

⁴ Po aty, fq. 11

⁵ Aleksandër Stipçeviq, *Ilirët Historia Jeta Kultura simbolet e Kultit*, Prishtinë, botimi i dytë, 1990, fq. 286

⁶ Agim Bido, *Arti popullor në veshje e tekstil*, Tiranë, 1991, fq. 61-62

forma gjeometrike më e vjetër e zbukurimit deri më sot.⁷ Zig-zagun si ornament që e gjejmë në traditën e veshjes sot dhe punimeve në gurë, dru e të poçerisë, dhe në përgjithësi në artin e neolitikut në lashtësi, mund të pohojmë se këto simbole janë përdorur në të gjitha periudhat historike, e deri në kohën e sotme. Këtë e pohojnë edhe studjuesit e besimit, të cilët pohojnë se gjatë gjithë zhvillimit të shoqërisë njerzore, disa simbole të shenjëta, kanë mbetur të pandryshuara deri në ditët e sotme.⁸ Si simbol zig-zaku i përket periudhës së matriarkatit, dhe është ornamenti më i përdorur në traditën etnografike të shqiptareve që përveç tekstilit, shfaqet i gdhendur në, gurë, metal, dru etj. Krahas përdorimit të zik-zakut, dhe trekëndëshit në materiale të forta dhe në tekstil, këto simbole janë hasur shpesh të gjenden në lokalitete arkeologjike, që dëshmojnë se këto simbole të lashta të kultit janë përdorur nga mjeshtër dardan, në tekstil, dru, metal dhe në guri, që nga epoka e neolitikut.



Fig. – 3 Dëshmi arkeologjike: Foto 1, 2 dhe 5 zbulime në fshatinë Dumnicë, komuna e Besianës, Foto 4. Trekëndëshi si symbol i plleshmërisë dhe pema e jetës ngritur mbi trekëndësh, në fshatin Majac. Foto 5. Fshati Boshlan, komuna e Vushtrrisë.

Trekëndëshi në pjesën e poshtme, te pema e jetës, në gurin e varrit të zbuluar në fshatin Majacë, komuna e Podujevës, tregon se kemi të bëjmë me një Dea Madre (krijuesja femër). Degët në të dy krahët e trungut, që ngritën lart, e kanë pamjen e “Pemës së jetës” së besimit në lashtësi. Nëse e analizojmë me vëmendje, “Pemën e jetës”, të paraqitur në këtë gurë varri, në njërën nga degët lartë në anën e djathtë e vërejmë kryqin, që mendoj se e paraqet botën e krishterë perëndimore. Trekëndëshi në besimet e mëvonshme sit e krishterimi, që simbolizon trini tetin, është huazuar nga themelet e teologjisë së lashtë. Origjina e simboleve, që sot hasen te veshja e grave shqiptare të rajonit të Medvegjës, i përkasin periudhës së krijimit të besimit në mëndjen e njeriut, gjë që dëshmojnë traditën autoktone, të besimit dhe krijimit të simboleve artistike, me plotë botëkuptime teologjike shumë të lashta. Sipas studiueses Fatbardha Demit, lidhur me simbolet e kultit kuptojmë se popujtë e ndryshëm në lashtësi, nuk e njihnin kuptimin e “zbukurimit”, siç shprehen gabimisht arkeologët dhe ata që merren me veshjen e lashtesisë

⁷ Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq.32

⁸ Po aty, fq. 35

apo të traditës. Këtë fakt e verteton edhe zig-zaku që është përsëritje e simbolit të femrës (V), që e shikojmë në objektet e hititeve të lashtë, apo të figurave të femrave nudo të para-historise.⁹ Nga këto burime kuptojmë se zig-zaku është ornament i më i përdorur në traditën etnografike të shqiptarëve dhe të gdhendjeve në gurë, dru si në magje, të djepeve, veglave muzikore, të furkave që përdoren për tjerren e leshit, në kostumet e burrave, grave, në punimin e sigjaveve, qylymave, në poçëri, etj.



Fig. – 4 Dëshmi arkeologjike: Foto 1, 2 dhe 5 zbulime në fshatinë Dumnicë, komuna e Besianës, Foto 4. Trekëndëshi si symbol i plleshmërisë dhe pema e jetës ngritur mbi trekëndësh, në fshatin Majac. Foto 5. Fshati Boshlan, komuna e Vushtrrisë.

Dy trekëndësha që lidhen në një kënd, ku e formojnë “sëpatën dy tehesh”, që shpesh haset edhe e skalitur në gurë në gjetjet arkeologjike, sipas shumë studiuesve e simbolizojnë sëpatën si simbol të plleshmërisë. Dy trekëndëshat e qëndisur në këtë formë (X), të krishterimi shprehin edhe origjinën e kryqit të Shën Andreut. Simboli kryesor i besimit të krishterë Kryqi (dy V), të bashkangjitura, në anë të kundërt, është figura gjeometrike, më e lashtë që e ka shprehur femrën në parahistori dhe më vonë. Krijuesi Shqiponja dhe Kryqi (dy V), që në artin parahistorik, shprehin perëndeshën Shqiponjë, vazhdojnë të jenë simbolet kryesore të besimit dhe shoqërisë së Evropës.¹⁰ Nëse i analizojmë me vëmendje e shohim se, rëndësi të veçantë të kjo veshje kanë padyshim, motivet të punuara me elegancë, dhe simbolet që përdoren për stolisjen e kokës, ku veçohet kryqi i Andreut, i futur brenda rrethit, me madhësi që e mbulon veshin, që zakonisht është qëndisur ose punuar me rruaza. Në këtë kryq është i ngjitur bistaku i punuar me fije floku, që në të dy veshët vendoset nga një kryq me bistak, që popullata e kësaj treve e quajnë “Shive”.

Lidhja e të dy veshëve përmes kurorës të ngritur mbi ballë, e cila është punuar në formë topash me madhësi të njëjtë, dhe me ngjyra të ndryshme, mund të pohojmë se e paraqesin ylberin. Nëse i bëjmë një analizë kurorës dhe topthave me ngjyra, kuptojmë se topthat me ngjyrë të katër, që simbolizojnë ujin, vendosen mbi vesh, ku veshi simbolizon liqen, prej ku lëshohen shivet mbi shtatin e gruas. Nëse e analizojmë me kujdes shohim se prej topthi me ngjyrë të kaltër e deri te topthi me ngjyrë të bardhë, i cili gjithmonë qëndron në pikën më të lartë të kokës, i kemi gjithsejtë shtatë toptha, e të cilët simbolizojnë shtatë ngjyrat e Ylberit. Është me rëndësi të theksohet se te kurora e punuar në formë ylberi me toptha të vegël, topi me ngjyrën e bardhë qëndron në mes të kokës, pra është pika më e lartë e tërë kostumit të grave, ashtu sikurse edhe te veshja e meshkujve që është plisi i bardhë. Me rëndësi janë edhe bistakët (Shivet) e qëndisura që lëshohen për fytyrë prej veshëve e deri në bel, në fund të qëndisura me rruza e që në të shumtën e rasteve, lidhen mes veti në shpin (prapa trupit), me kapës të qëndisura. Këta bistak të quajtura shive, ngjasojnë në çdo detaj me veshjen karakteristike dhe aristokrate të zbuluar në mozaikun që i përkiste perandoreshës Teodora, e cila ishte bashkëshortja e perandorit bizantin Justinjan, për të cilin

⁹ <https://pashtriku.org/fatbardha-demi-perendesha-me-e-fuqishme-e-te-gjitha-kohrave-ne-xhoken-e-mirditores-i/>,

¹⁰ Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq. 39

dihet se ishte me origjine dardane, dhe atë pikërisht nga rajoni i Medvegjes së sotme.¹¹ Shivet e punuara me fije floku, simbolizojnë shiun (andaj edhe emri Shive, ngjason me shiun, që mund të shpjegohet vetëm përmes gjuhës shqipe), ndërsa kryqi simbolizon Zotin. Shivet që lëshohen prej veshi në shtat mund të pohojmë se e kanë bekimin e Zotit për jetë të shëndetshme. Kurora shumë ngjyrëshe të kjo veshje që vendoset prej veshi në vesh dhe që nënkupton ylberin që bie në dy liqeje mendoj se simbolizon, shëndetin, bukurinë dhe zhvillimin e shtatit të femrës.

Se veshët në këtë rast simbolizojnë ujin, kjo e bënë të kuptueshme, kur nga veshët mbi shtatin e gruas lëshohen bistakët e gjatë të punuar prej flokëve dhe rruzave, e të cilat na shtynë të mendojmë se simbolizojnë shiun, jetën, gjallërinë, shëndetin, elemente këto të paraqitura edhe në mozaikun të veshja e Perandoreshës Bizantine Teodorës.¹² Femra me kurore nga veshi në vesh gjenden edhe në shtatoret e femrave të punuara në gurë. Deri më tani, zbulimet arkeologjike kanë nxjerrë në sipërfaqe disa shtatore, ku njëra ndër to ruhet edhe sot në Muzeun e Durrësit. Topthat me ngjyra të ndryshme që përdoren për ta formuar kurorën janë të rralla, që janë ruajtur në traditën dardane, dhe në traditën tonë popullore deri më tani, mund të pohojmë se në formë të ngjashme, edhe sot mund t'i ndeshim te hundzakët (popullata me origjinë nga Evropa, që ende jeton në Afganistan). Te fiset e lashta, ishte dukuri përsëritja e simboleve, që janë përdorur vetëm me një qëllim për të dëshmuar se janë fise që mbroheshin nga Krijuesi.

Ylberi është një fenomen qiellor, që shfaqet kur rrezet e diellit shkëlqejnë në pikat e imta të ujit. Në këtë rast, rrezet e diellit marrin formën e një gjysmërrethi, në të cilin duket spektri i 7 ngjyrave, që nga ana e jashtme fillon me ngjyrën e kuqe dhe në anën e brendshme mbaron me ngjyrën vjollcë.¹³ Ylberi është shfaqur në kulturën botërore që në kohët më të hershme të qytetërimit. Fenomeni i ylberit gjendet edhe në Bibël. Në testamentin e vjetër *ylberi simbolizon besëlidhjen* mes njeriut dhe Zotit.¹⁴ Ylberi si fenomen haset në mitologjinë e shumë popujve të lashtë, ashtu sikurse te popujt e tjerë, edhe te populli shqiptar, ka legjenda dhe shpjegime të shumta, për lidhjen e kësaj dukurie me besimin e zotit.

¹¹ <http://www.zemrashqiptare.net/news/54188/qazim-namani-veshja-e-grave-shqiptare-ne-rajonin-e-medvegjes.html>,

¹² Po aty

¹³ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Ylberi>

¹⁴ <https://vse-o-tattoo.ru/sq/symbolic/lgbt-symbols/raduga-2>,



Fig. – 5 Kurora për stolisjen e kokës, te veshja e grave shqiptare në trevën e Medvegjës.

Zbukurimi i kokës me kurorë gjendet edhe në shtatoret e mbretëreshave të antikitetit objekte dhe lokalitete arkeologjike. Femra e stolisur me kurorë nga veshi në veshin tjetër, ishte përdorur edhe te mbretëreshat bizantine. Po ashtu janë qëndisur me kujdes një varg trekëndëshash, që hasen te besimet e lashta të periudhës së matriarkatit, e që më vonë trekëndëshi është marrë si bazament i teologjisë së krishterë-trinitetit dhe simbol i plleshmërisë. Në traditën e kësaj veshje e hasim kryqin brenda rrethit. Tek “Shivet” e veshit shikojmë simbolin e kryqi brenda rrethit, i cili është kryqi i fiseve druide të kelteve dhe të Irlandës. Këtë simbol e hasim edhe te shqiptarët, këtë e dëshmojnë objektet e traditës sonë popullore, por shpesh është gjetur dhe në objektet arkeologjike. Secili prej këtyre simboleve dhe çdo detaj tregon besimin në kulte të ndryshme që i përdorën ilirët në përgjithësi.



Fig. – 6 Kryqi me (dy V), Shivet, Kurora, Ylli gjashtë cepësh, Hëna dhe simbolet ornamentale te veshja e grave në rajonin e Medvegjës.

Ndër elementet e përdorura te stolisja e kokës, që e bëjnë me interes për ta studiuar këtë veshje është edhe shamia që vishet në pjesën e prapme të kokës e cila po ashtu qëndrohet me motive të shumta, dhe në shumë raste mbulohej me Lakuriqin e Natës, që punohej me përkushtim dhe elegancë, duke përdorur rruza me ngjyra të ndryshme. Sipas hulumtimeve shkencore është vërtetuar se Lakuriqët e Natës janë gjitarët më jetëgjatë në botë, në krahasim me madhësinë e trupit të tyre, po ashtu janë mbrojtës e natyrës nga insektet. Nga gjithë kjo mund të pohojmë se përdorimi i kësaj figure si mbrojtës e vrojtues të natës (errësirës), në këtë veshje ka kuptimin dhe të jetëgjatësisë, mbrojtjes nga prapavija prej intrigave, pabesive dhe të këqijat që mund të vijnë nga njerëzit e ligë.¹⁵

¹⁵ <http://www.zemrashqiptare.net/news/54188/qazim-namani-veshja-e-grave-shqiptare-ne-rajonin-e-medvegjes.html>



Fig. – 7 Lakuriqi i natës i punuara me dorë që vendosej mbi shami në anën e prapme të kokës, të punuara nga Ajshe Baftiu-Berisha, fshati Sfirçë.

Ndjenja e frikës te njeriu parahistorik, ishte mbrojtja nga rreziku dhe dëshira për të jetuar. Sipas miteve nga errësira dhe frika, që e kaploi njeriun parahistorik, u krijua kulti i hënës, si kulti i parë i njeriut primitive. Ishte njeriu parahistorik që krijoi idenë e Fuqisë së mbinatyrshme “te lartësisë”, duke ndërë frikën prej ndryshimeve të formës së saj dhe errësirës që mbretëronte me largimin e dritës së zbetë natën.¹⁶ Nëpërmjet gjuhës shqipe shpjegohet kuptimi i emrit Sellena: Hëna dritë-argjend, mbretëreshë e natës, largohej duke “sjell” ndriçimin e fortë të Diellit, një shkëmbim i pandërprerë dritash.¹⁷ Fatbardha Demi, në studimet e saj për simbolet e kultit në Dardani shkruan se simboli i besimit (Hëna Yll), është gdhendur në objektet arkeologjike të arbërve parahistorik.¹⁸ Në jelek e kemi të qëndisur yllin gjashtë cepësh, të formuar nga dy trekëndësha, që rrethohet me dy hëna vetullore. Simbolin e “Yllit gjashtë cepësh” që në veshjen e grave të Medvegjës e hasim tek jeleku, vërejmë se kemi një yll te formuar nga dy trekëndësha të rrethuar me pikat, dhe te ndodhur ne mes te dy gjysmëhënave, shpreh tre fazat e hënës, ku hëna e plote e shprehur me lulen e formuar nga dy trekëndëshat ylli gjashtë cepësh dhe dy hënat vetullore. Është interesant fakti që brenda lules së dy trekëndëshave, ndodhet një rreth i vogël që ka brenda një lule tjetër, shpreh krijuesin (lulja e vogël) të besimit hënor të periudhës së matriarkatit (dy

¹⁶ <http://www.zemrashqiptare.net/news/53636/fatbardha-demi-dy-fjale-ge-ndryshuan-historine-e-botes-ii.html>,

¹⁷ <http://www.zemrashqiptare.net/news/53636/fatbardha-demi-dy-fjale-ge-ndryshuan-historine-e-botes-ii.html>,

¹⁸ <https://floripress.blogspot.com/2019/01/deshmitari-dardan-i-manastirit-te.html>,

trekëndësha të kryqëzuar). Rrethi apo lulja e vogël, e cila ndodhet brenda lules së dy trekëndëshave, mendoj se e shpreh besimin e Zotit.



Fig. – 8 Jeleku me motive gjeometrike parahistorike, kultit të hënës, diellit dhe lakuriqin e natës etj.

Simbolet që gjenden në traditën Ilirëve e Arbërve i përkasin periudhës së krijimit të besimit në lashtësi, gjë që dëshmon se janë, jo vetëm autokton, por ndoshta dhe ndër autoret e parë të krijimit të teologjisë së besimit në lashtësi.

Punimi i Jelekut në kulturën popullore shqiptare i kushtohet rëndësi shumë të madhe. Jeleku qëndret me simbole dhe dekorime të çmueshme, për të treguar vlerën e bartësit të tij. Jeleku i burrave të kësaj treve po ashtu punohej me stil sa më të lartë, sepse përmes jelekut mashkulli tregonte fisnikërinë, besnikërinë, traditën, kulturën dhe pasurinë e tij. Mendoj se te shqiptarët edhe emërtimi Jelek, ka kuptimin je i pasur, ke lekë, ke karakter të fortë, ke vlerë parash.

Te pështjellaku të moshat e reja para martesë e gjejmë të qëndisur yllin gjashtë cepësh njëngjyrësh. Pështjellakët e përcaktojnë moshën dhe statusin e femrave të kësaj ane.



Fig. – 9 Pështjellakët që bartin gratë shqiptare në trevën e Medvegjës: Foto 1. Pështjellaku që e bartin vajzat e reja, para martesës. Foto 2. Pështjellaku që e bartin nuset e reja para se të lindin fëmijë. Foto 3. Pështjellaku që e bartin gratë gjatë periudhës së lindjeve të fëmijëve. Foto 4. Pështjellaku që e bartin gratë e moshuara pas kryerjes së ciklit të lindjeve

Simbolin e sëpatës që e hasim te pështjellaku i grave të martuara, e të cilat janë në moshë që e kryejnë procesin e lindjeve, mendoj se shpreh simbolin e sëpatës dy telesh, që e gjejmë edhe në objektet arkeologjike. Sëpatat dy telesh, janë përdorur në lashtësi për flijime, dhe shiheshin si simbole të rrufeve dhe stuhisë.¹⁹ Disa studiues sëpatën dy telesh e shohin edhe si simbol të pleshmërisë. Sëpatat janë objekte që kanë hyrë në përdorim që nga epoka e gurit, për të cilat mendohet se përveç përdorimit si mjet pune, ato kishin edhe motive të kultit ose magjisë. Më vonë sëpatat janë punuar nga metalet e ndryshme dhe janë konsideruar si almuget më të rëndësishme shtëpiake. Sëpatës së dyfishtë (Labrys), rëndësi të veçantë i kushtohet në Kretë, e cila lidhet me kultin e Nënës së Madhe. Sëpata është simbol i Nënës Hyjneshë, dhe njëkohësisht simbol lunar, dhe simbol i rufesë dhe vetëtimës. Te shumë studiues mbizotëron mendimi se sëpata është simbol i pleshmërisë që lidhet me jetën dhe ripërtëritjen e natyrës. Për përdorimin e këtij simboli në luginat e lumenjve Vardar, Moravë e Danub, ka shkruar H.G. Bucholz, i cili në librin e tij pohon se kjo kulturë përmes këtyre lumenjve depërtoi në Evropën Qendrore dhe veriore.²⁰

Përparësja në foton e paraqitur në vijim, është punim dore me vjetërsi mbi 100 vjeçare, e trashëguar nga brezat e mëparshëm në familjen Berisha në fshatin Sfirçë. Kjo përparësë është bartur mbi këmbishën e gjatë, të qëndisur me ornamente të kultit dhe florale. Mbi përparës janë bartur tre mindila, të qëndisur, po ashtu me plotë ornamente të kultit, që janë punuar duke i dhënë veshjes botëkuptime religjioze, dhe estetike pasi që janë renditur me shije.

¹⁹ Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq. 62

²⁰ Aleksandër Stipcevic, Ilirët Historia Jeta Kultura dhe simbolet e kultit, Prishtinë, 1990, fq. 371



Fig. – 10 Përparëse të cilën gratë shqiptare të Medvegjës e quajnë Përparc, dhe mindilat të cilët vihen mbi Përparëse

Te kjo veshje, mjaftë e pasur është edhe pjesa e stolisjes me punime për çdo pjesë të trupit. Në foton në vijim ofrojmë zbukurime qafë, dore, beli dhe krahu, të punuara me dorë, me rruza dhe me plotë simbole të kultit.



Fig. – 11 Zbukurime të punuara nga Ajshe Baftiu-Berisha, fshati Sfirçë: Foto 1. Kallon që vihej në bel mbi këmishën e gjatë. Foto 2. Stoli për gra të moshuara. Foto 3. Stoli që lëshohej në anën e përparme të trupit, prej pas qafës mbi dy duart e nuseve të reja, qafore të punuara me rruza.

Prej materialit etnografik të trashëgimisë kombëtarë të shqiptarëve, mund të nxirren shumë simbole të kultit, të cilat na mundësojnë studimet më të thella në disiplinat shkencore, të antropologjisë, arkeologjisë dhe fushave tjera të historisë. Po ashtu në vijim ofrojmë fotot, ku dy fotot e paraqitura në rendin e parë, janë zbukurime që barten rreth beli, ndërsa fotot në rendin e dytë, janë amulete me motive kulturi e magje, të cilat barten në trup dhe në kokë.



Fig. – 12 Zbukurime të punuara nga Ajshe Baftiu-Berisha, fshati Sfirçë: Foto 1 dhe 2 detaje për stolisjen e belit. Foto 3, 4, 5 dhe 6 detaje për stolisjen e kokës.

Mjaftë e pasur me ornamente kulturi dhe zbukurime është edhe veshja e burrave në rajonin e Medvegjës. Me simbole të kultit është punuar edhe Qosteku (çantë), për mbajtjen e orës së xhepit.



Fig. – 13 Foto 1. Sadri (Rexhep) Rafuna, i lindur 1895, Foto 2, Murat (Ali) Radeci, i lindur në vitin 1892, Foto3. Qeste (çantë) për bartjen e orës së gjepit, Hasan (Halit) Salihu, nga fshati Gërbac, punuar me rruza nga gruaja e tij Zelihanja

Veshja e burrave kryesisht përbëhet nga këto pjesë: Plisi, Marama, Mitani (i Verës dhe i Dimrit), Jeleku, Gjurdia, Guna, Shoka, Tirqit, Tlinat, Çorapët, Shputat, Opingat etj. Familjet e pasura bartnin edhe Qyrkun, Xhamadanin, Fremgjymlekun, Gjyben e veshje tjera të qepura prej cohe.²¹ Meqenëse kjo veshje e jona kombëtare, i ka ruajtur të gjitha këto tipare dhe vlera kulturore, është interes i yni kombëtar, që kjo

²¹ Sabit Uka, Jeta dhe Veprimtaria e shqiptareve të Sanxhakut të Nishit deri më 1912, Prishtinë 1995, fq. 198

veshje të prezantohet sa më shumë në muzetë tona popullore, dhe të stimulohet tradita e punimit të saj, si relikti i rrallë dhe me shumë vlera të larta të kulturës dhe artit tonë popullorë. Kjo popullatë autoktone shqiptare, përmes artit të shprehur në kulturën e tyre, ruajti edhe kulturën e lashtë të qytetërimit perëndimor, andaj mendoj se kjo veshje si relikti i rrallë në Evropë, e meriton që të ketë edhe mbrojtjen nga UNESCO.

PËRFUNDIME

1. Veshja tradicionale e popullatës shqiptare në rajonin e Medvegjës sot, përfaqëson në përgjithësi trashëgiminë kulturore autentike të popullatës shqiptare në territorin e Dardanisë Qendrore.
2. Motivet zbukuruese në këtë veshje, shfaqen në forma të ndryshme, dhe janë pjesa më artistike që realizohen mbi pëlhurë, me traditën dhe frymëzimin e bartur brez pas brezi te femra shqiptare e kësaj ane.
3. Dukuri e qëndisjes së kësaj veshje është renditja e motiveve zbukuruese të ornamenteve në mënyrë simetrike në të dy anët e trupit. Tërësia e ornamenteve të qëndisura dhe përdorimit të shumë ngjyrave, krijon një sistem të plotë dekorativ me simbole të kultit, që këtë veshje e bëjnë të dallueshme me veshjet e grave nga krahinat tjera etnografike shqiptare, dhe popujt tjerë të rajonit dhe me gjerë.
4. Kostumet e veshjes së grave të rajonit të Medvegjës pasqyrojnë traditën e lashtë të shprehjes estetike, duke nxjerrë në pah elementet më të lashta dhe domethënëse të artit tradicional që nga parahistoria, Dardanisë antike e deri në ditët e sotme.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Aleksandër Stipçeviq, Simbolet e Kultit te Ilirët, Prishtinë, 1979, fq. 9
2. Po aty, fq.10
3. Po aty, fq. 11
4. Po aty, fq. 11
5. Aleksandër Stipçeviq, Ilirët Historia Jeta Kultura simbolet e Kultit, Prishtinë, botimi i dytë, 1990, fq, 286
6. Agim Bido, Arti popullor në veshje e tekstil, Tiranë, 1991, fq. 61-62
7. Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq.32
8. Po aty, fq. 35
9. <https://pashtriku.org/fatbardha-demi-perendesha-me-e-fuqishme-e-te-gjitha-kohrave-ne-xhoken-e-mirditores-i/>,
10. Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq. 39
11. <http://www.zemrashqiptare.net/news/54188/qazim-namani-veshja-e-grave-shqiptare-ne-rajonin-e-medvegjes.html>,
12. Po aty
13. <https://sq.wikipedia.org/wiki/Ylberi>
14. <https://vse-o-tattoo.ru/sq/symbolic/lgbt-symbols/raduga-2>,
15. <http://www.zemrashqiptare.net/news/54188/qazim-namani-veshja-e-grave-shqiptare-ne-rajonin-e-medvegjes.html>
16. <http://www.zemrashqiptare.net/news/53636/fatbardha-demi-dy-fjale-qe-ndryshuan-historine-e-botes-ii.html>,

17. <http://www.zemrashqiptare.net/news/53636/fatbardha-demi-dy-fjale-qe-ndryshuan-historine-e-botes-ii.html>,
18. <https://floripress.blogspot.com/2019/01/deshmitari-dardan-i-manastirit-te.html>,
19. Fatbardha Demi, Selenizmi besimi që sundon botën, Tiranë, 2016, fq. 62
20. Aleksandër Stipcevic, Ilirët Historia Jeta Kultura dhe simbolet e kultit, Prishtinë, 1990, fq. 371
21. Sabit Uka, Jeta dhe Veprimtaria e shqiptareve të Sanxhakut të Nishit deri më 1912, Prishtinë 1995, fq. 198